



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRISHTINU/ MUNICIPAL
MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj.24902/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, me gjyqëtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Naim Thaqi duke vendosur sips Aktvendimit të Gjykatës së Lartë për Kundervajtje me nr;1356/2011,të dt.15.11.2011, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Slagjana Dobrislav Vasiq nga Gracanica, për kundërvajtje nga neni 6.parg.2 lidhur me nenin 16 parg.1 pika 2. të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen,dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73.74.195, dhe 199 të Ligjit mbi kundervajtjet, me dt.**23.12.2011** merrr këtë,

AKTVENDIM

E PANDEHURA:Slagjana Dobrislav Vasiq e lindur me 07.12.1966 në Prishtinë,tani jeton në”Lepinë”K.Gracanicës,e martuar,nenë e dy femijve, e gjendjes së mesme ekonomike,shkollën e lartë të kryer,punon si Zv.Komesare e NJ-së në Prishtinë.

Ë s h t ë p ë r g j e g j e s

Sepse si Zv.komesare e NJ-së në Prishtinë,nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor,edhe pse ka qenë e njohtuar se është përfshirë në listen e Zyrtarve,të cilet janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë.

Me veprim të këtill ka kryer kundervajtje nga neni 6 pika.2.lidhur me nenin 16 parg.1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë,dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë publik, andaj për këtë:

D E N O H E T

Me gjobë në të holla në shumë prej **800 (tetëqind)** Euro, të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktvendimi merr formën e prerë. Në dobi të të hyrave gjyqësore të Kosovës,në Prishtinë në xhir. Rrjedh nr. 1000430070000518.

Nëse gjoben e shqiptur nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do ti zëvendësohet në denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh duke ju llogaritur 15 EURO në një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.Në emer të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5 EURO, në afat dhe xhirrollogari të njëjtë me gjobën.

Pagesa e gjobes bëhet në të gjitha bankat e qytetit,kurse paushalli gjyqësorë në arkën e gjykatës Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë,me kërkesën nr.01-3212/11 të parashtruar gjykatës me datën 19.07.2011 për inicimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurës të permendur me lartë, për kundervajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata komunale për kundervajtje në Prishtinë duke vepruar sipas kërkesës,e zvillon proceduren kundervajtse dhe të pandehurën e shpalli fajtor dhe e denoi me gjobë prej 800 eurosh,dhe në emer të paushallit gjyqësor në shumën prej 5 eurosh.

E pandehura Slagjana Vasiq në aftain e parapar ligjor e atakoj Aktvendimin e Gjykatës Komunale për Kundervajtje në Prishtinë,me arsyetim se aktvendimi nuk është i xhirr në menyrt të drejtë.

		REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT		AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.		Nr. Prot	
Dep.		Br Prot	
Dep.	D.P	Prot No	03-5149/11
Nr. I faq		Data	
Broj stranica		Datum	30.12.2011
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			

Gjykata e Lartë për Kundervaje me dt.15.12.2011, me Aktvendimin me nr:1356/2011, date 15.11.2011 e abrogon Aktvendimin me nr.Regj:24902, lënden ja kthenë Gjykatës së shkallës së parë në rivendosje ku e obligon që të ndermerr disa veprime dhe të bënë vertetimin e provave që e pandehura i frekson në ankesë. Duke veprue sipas udhëzimeve të cekura në Aktvendimin GJ.L.nr:1356/2011, me dt.15.11.2011, thirri në cilësin e deshmitarit parshtruesin e kërreses përfaqsesin e Agjencionit Antikorrupcion në Prishtinë Agron Bajramin, dhe Koridatoren në Komisioni për Ndhim juridike në Prishtinë Drita Regjepin.

Përfaqsesi i Agjencionit Antikorrupcion Agron Bajrami në deklaratën e tij thekson: Se është e vertet se Slagjana Vasiqi në cilësin e Zv.komesarës për NJ-ke, nuk e barë deklarin e pasuris në afatin e paraparë ligjor deri me **31 mars 2011**. Ndersa sa i perkët Formularëve të cilët gjoja nuk ju kanë dorzue të pandehurës në gjyhen e vet amtare-serbe, këto thenje nuk qendrojn nga se në **Veb faqen e Agjencionit është i publikuar formulari në tri gjuhët**, ku ka mundur të sherbehet me cilin do formular. Shtoj se ne si Agjencion nuk i kemi derguar asnjë zyrtari formularët mbi deklarin e pasurisë, por i kemi udhëzue që të njejtit mund ti gjen në Veb faqet e cekuar më lartë.

Kordinatorja në komisionin për ndihm juridike Drita Rexhepi në cilësin e deshmitarës thekson: Se është e vertet se të gjith antarët e Bordit ku edhe Vasiq Slagjana kan qenë të njohtuar për obligimin që e kan për ta bërë deklarin e pasurisë pranë Agjencionit Antikorrupcion, kjo çeshtje është biseduar disa herë, por nuk e dij se të njetës a ju ka dergue formulari në menyre elektronike.

Gjykatësi edhe një herë shqyrtoj deklaratën e të pandehurës të dhenë para kësaj gjykate me datën 09.09.2011, ku thekson se është e vertet se nuk e kam bër deklarin e pasurisë nga shkaku se formularë kanë ardhur në gjuhen shqipe dhe nuk kam kuptuar se çfarë të dhenash kërkohen. Më pastaj kam menduar se unë nuk jam e obliguar ta bej deklarin e pasuris, ku pas disa ditësh kam kontaktuar me zyrtarin për ndihm juridike, i cili më ka deklarue se edhe unë jam e obliguar që ta bej deklarin e pasuris. **Pasi që e kam sigurue formularin, e kam plotsue dhe ja kam çue Daut Morinës-Drejtor i administrates për ndihm juridike që ta dergoj pranë agjencionit në fialë.** Më pastaj nuk kam marr kurrfar informate nga ai deri dje, kur me ka kerkue falje pse nuk e kishte dergue formularin edhe pse e kishte marr si obligim. Dhe në fund deklaron se sikur ta kisha pas formularin në gjyhen që unë e kuptoj do ta kasha krye këtë obligim.

Gjykata thirri në cilësin e deshmitarit me dt.21.10.2011, Daut Jantz Morinën i cili deklaron se nuk është e vertet se Slagjana Vasiqi mua ma ka pru formularin për deklarin e pasuris në Agjencioni Antikorrupcion. Sipas pozitës që mbaj nuk jam i obliguar që ti njohtoj e as të merrem me zyrtarër të cilët janë të obliguar për deklarin e pasuris.

Gjykata me kujdes shqyrtoj vrejtjet e dhenuna nga Gjykata e lartë sipas Aktvendimit me nr:1356/11, të dtë 15.11.2011, pastaj ndërmorri të gjitha veprimet procedurale, thirri edhe deshmitarë tjerë, edhe një here shqyrtoj kërkesën, deklaratat të deshmitarve, dhe provat të paraqitura nga institucioni përkatës, si dhe shkresat tjera të lëndës, dhe erdhi në përfundim se e pandehura Slagjana Vasiq ka kryer kundervajtjen e cila e ngarkon, dhe se duhet të përgjigjet për kundervajtjen të cilen e ka bërë.

Me rastin e caktimit të lartësisë së gjobës gjyqtari e pati parasyssh peshen e kundervajtjes, si dhe rrethanat tjera lehtësuese dhe renduese.

Duke i marrë prasysh të gjitha këto vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke qenë i bindur se edhe me këtë gjobë mund të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit.

Me sa u tha me lartë u vendos sin e dispozitiv te këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundervajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditë që nga dita e marrjes së aktvendimit e nëpërmes kësaj Gjykate.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDERVAJTJE NË PRISHTINË.

Gjyqtari
Murat Paçarada

